



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/114

Datë: 07.11.2016

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4 dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011, dhe të nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 7 nëntor 2016, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Koncept Dokumenti për Shërbimin Gjeologjik të Kosovës.
2. Obligohet Ministria e Zhvillimit Ekonomik dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e këtij vendimi, në pajtim me Rregulloren e Punës së Qeverisë.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/114

Datë: 07.11.2016

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 29 të Ligjit nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011, dhe të nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 7 nëntor 2016, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet kërkesa e Ministrisë së Punëve të Jashtme për ndarjen e mjeteve financiare në shumë prej 270,000 (dyqind e shtatëdhjetë mijë) euro, për shlyerjen e obligimeve ndaj kompanisë "Patton Boggs" sipas kontratës Shërbime Lobimi dhe Konsulencë me Nr: MPJ/216/13/297/215 të datës 28.02.2014 të nënshkruar në mes të MPJ-së dhe Patton Boggs.
2. Mjetet financiare nga pika 1. e këtij vendimi ndahen nga Shpenzimet e Paparashikuara, nën-programi Shpenzimet e Paparashikuara me kod 13100, kategoria ekonomike e rezervës dhe transferohen në Ministrinë e Punëve të Jashtme (216) në nën-programin Shërbimet e Konsulencës me kod 28600, në kategorinë ekonomike mallra dhe shërbime.
3. Obligohet Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë